



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-014

Prishtinë, më 26 prill 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 26 PRILL 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga Grupet Parlamentare: Adem Grabovci, Ibrahim Makolli, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Sasha Rashiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të mbajtur më 19 prill 2011,
2. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 prill 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 prill 2011.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjet plenare, më 28 prill 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 28 prill 2011, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 prill 2011,
4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë.
5. Projektligji për shërbimet e sigurisë private,
6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L -123 për shoqëritë tregtare,
7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim,
8. Projektligji për gjendjen civile,
9. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme,
10. Plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011,
11. Miratimi i Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

3.1 Propozim-Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me emërimin e një anëtari në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Legjislacion që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtari në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.2 Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010

Kryesia vendosi që Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010, të radhitet në rend dite për mbledhjen plenare, më 28 prill 2011.

3.3 Iniciativa e grupit të deputetëve për debat parlamentar

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me iniciativën e cekur më lart, e shtyu atë për mbledhjen tjetër të radhës, me qëllim që ajo të specifikohet nga grupit parlamentar që e ka iniciuar këtë çështje dhe pastaj të vendoset për procedimin e saj.

3.4 Prezantimi i Projektit “E-Parlament” /Parlamenti Elektronik/

Prezantimin e këtij Projekti, në Kryesinë e Kuvendit e bëri përfaqësuesi i Kompanisë NEKST SENSE (next sense) nga Shkupi. Ai në hollësi i njoftoi të pranishmit për dobitë e këtij programi, i cili rrit transparencën dhe efektivitetin e organeve të Kuvendit në procesin ligjvënës; ofron lehtësimin e shërbimeve parlamentare, qasjen e të gjitha palëve të interesuara, zvogëlimin e shpenzimeve materiale dhe shumë përparësi tjera që mund të arrihen përmes shfrytëzimit të sistemit elektronik të quajtur “E-parlament” në Kuvendin e Kosovës.

Prezantimin e sistemit “E- Parlament” e mundësoi Zyra NDI për mbështetje Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën **12:40** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.